

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-016/14

Prishtinë

2 Dhjetor 2014

Në çështjen juridike të:

G. B.

Sllovi

Pala ankuese

Kundër

Z. J.

Kragujevac, Serbi

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Willem Brouwer, Kryetar i Kolegjit, Esmat Erterzi dhe Sylejman Nuredini, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/22/2008 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA42232), pas shqyrtimit të mbajtur më 2 Dhjetor 2014 mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Miratohet ankesa e G. B. ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/22/2008 (lënda e regjistruar si KPA42232) të datës 28 gusht 2008 si e bazuar.

2. Anullohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/22/2008 (lënda e regjistruar si KPA42232) i datës 28 gusht 2008 për shkak të tërheqjes së kërkesës dhe kërkesa e Z. J. e regjistruar si KPA42232 hedhet poshtë.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 18 shtator 2007 Z. J. (tani e tutje: pala përgjegjëse në ankesë) duke vepruar në emër të së ëmës së ndjerë, C. J. kishte dorëzuar një kërkesë pronësore në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) ku kërkonte ri-posedim si dhe kompensim për shfrytëzimin e pronës pa pëlqimin e tij për sa i përket ngastrës nr. 2981 që ndodhet në Komunën e Lipjanit, zona kadastrale Sllovi, me sipërfaqe prej 00.19.82 ha (nga tani e tutje: prona e kërkuar). Pala përgjegjëse në ankesë theksoi se e ëma e tij kishte humbur posedimin mbi pronën me datën 16 qershor 1999 për shkak të rrethanave të konfliktit në Kosovë.
2. Në mbështetje të kërkesës Z. J. paraqet
 - Fletën Poseduese Nr. 2 të lëshuar nga Zyra Kadastrale e Komunë së Lipjanit. Sipas Fletës Poseduese ngastra 2981, arë e klasit të 4 të me sipërfaqe 00.19.82 ha evidentohet në emër të C. J.
3. Më 10 prill 2008, një ekip i AKP-së kishte shkuar te prona dhe kishte vendosur një shenjë duke bërë kështu identifikimin e pronës. Në raportin e saj njoftues ekipi i AKP-së kishte shënuar se prona ishte një tokë e kultivuar e zënë nga një person i panjohur. Pasi që ishte konstatuar se prona e kërkuar ishte duke u shfrytëzuar, ekipi i AKP-së u mundua të identifikonte personin i cili e shfrytëzonte atë por pa sukses pasi që njerëzit që jetonin aty nuk e dinin ose nuk donin të tregonin për personin i cili e shfrytëzonte pronën. Identifikimi i pronës ishte kontrolluar në shkurt të vitit 2010 bazuar në koordinatat e GPS-it dhe ortofoton dhe ishte konstatuar se ai ishte bërë në mënyrë të saktë.

4. Pasi që asnjë palë përgjegjëse në kërkesë nuk kishte paraqitur përgjigje brenda afatit të paraparë, kërkesa u konsiderua si e pa-kontestuar.
5. Me vendimin e datës 28 gusht 2008 (KPCC/D/A/22/2008), Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) vendosi që pala përgjegjëse në ankesë kishte provuar se e ëma e tij e ndjerë C. J. ishte pronare e tokës së kërkuar dhe rrjedhimisht pala përgjegjëse në ankesë kishte të drejtë posedimi mbi pronën e kërkuar.
6. Pala përgjegjëse në ankesë nuk e kishte marrë vendimin e KKPK-së brenda afatit që parashihet për marrjen e vendimit.
7. Më 11 dhjetor 2013 pala ankuese kishte paraqitur ankesë kundër vendimit të KKPK-së.
8. Pala ankuese i kishte dorëzuar AKP-së kontratën e blerjes, të lidhur në mes të S.J. si shitës i pronës së kërkuar dhe B. B. në cilësinë e blerësit.
9. Më 23 janar 2014, pala përgjegjëse në ankesë kishte dorëzuar një përgjigje me shkrim ndaj ankesës. Në përgjigjen e tij me shkrim pala përgjegjëse në ankesë deklaroi me sa vijon:

“Unë Z.J., përmes kësaj vërtetohet se vëllai im, S. J. ia ka shitur ngastrën nr. 2981, me sipërfaqe prej 00.19.82 ha, B.B. diku gjatë viteve të 1990-ta. Ka qenë gabimi im që kur kam dorëzuar kërkesat në AKP, unë gabimisht e kam dorëzuar edhe kërkesën në fjalë dhe më pastaj nuk e kam tërbequr të njëjtën me kohë. Shpresoj që ju të pranoni kërkimin ndjesën time.

Pala përgjegjëse në ankesë gjithashtu kërkoi Mbylljen e kërkesës pranë AKP-së.

Pretendimet e palës ankuese

10. Pala ankuese kundërshton vendimin për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të fakteve. Ai thekson se babai i tij i ndjerë Beqir Bytyqi, e kishte blerë pronën e kërkuar dhe ajo shfrytëzohet nga ata që nga momenti i blerjes.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmëria

11. Ankesa është e palejueshme nëse pala ankuese nuk ka marrë pjesë në procedurën para AKP-së, përveç nëse pala ankuese është palë e interesuar e cila nuk e ka pranuar njofimin për kërkesën (në mënyrën e duhur) ose përndryshe nuk ka qenë në dijeni apo në mënyrë të arsyeshme nuk ka mundur të dijë për kërkesën para se ai të bënte ankesën (Neni 12.1 i

Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi Zgjidhjen e Kërkesave që ndërlidhen me Pronën e Paluajtshme Private përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale, i ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 dhe shiko për shembull Aktgjykimin GSK-KPA-A-095/12).

12. Nuk ka ndonjë indikacion se pala ankuese ka qenë e informuar për procedurën para AKP-së gjatë procesit të identifikimit të pronës apo deri në dhjetor 2013. Prandaj ankesa është e pranueshme. Gjithashtu nuk ka dyshim se pala ankuese është palë e interesuar.

Meritat

13. Pala përgjegjëse në ankesë ka tërhequr kërkesën e tij përmes deklaratës e cila përmendet në paragrafin 8 të këtij Aktgjykimi.
14. Sipas neneve 149,198 dhe 261 të Ligjit për Procedurën Kontestimore „në rast të tërheqjes së kërkesës, kërkesa duhet të refuzohet ose të hedhet poshtë. Këto dispozita ashtu si neni 12 paragrafi 2 i ligjit 03/L-079 mund të aplikohet përshtatshëm në procedurën para Kolegjit të Apelit të AKP-së
15. According to articles 149, 198 and 261 of the Law on Contested Procedure withdrawal of a claim implies that the claim should be rejected or dismissed.. This provision can, as Section 12.2 of Law 03/L-079 applies, mutatis mutandis be applied in this procedure before the KPA Appeals Panel.
16. Në kontekst të procedurës para Kolegjit të Apelit të AKP-së, kjo do të thotë se gjykata duhet ta pranojë ankesën dhe të konstatojë se Cveta Jovanović nuk është pronar dhe pala përgjegjëse në ankesë nuk ka të drejtë për ri-posedim. Gjykata Supreme anulon vendimin duke e hedhur poshtë kërkesën.

Këshillë ligjore

Sipas nenit 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Willem Brouwer, Kryetar i Kolegjit i EULEX-it

Esma Erterzi, Gjyqtar i EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, *Referent i EULEX-it*